



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Prokurimit - Komuna Junik

Datë: 13.07.2020

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, paragrafi 6 dhe neni 8, paragrafi 8.1.2 ii te Rregullat për parashtrimin e ankesave, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim (ankesës) të parashtruar nga Operatori Ekonomik, Segment Kosova sh.p.k, të datës: 08.07.2020, lidhur me tenderin “ **Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut**”, me numër të brendshëm të prokurimit: 636-20-011-1-3-6 dhe me numër të prokurimit: 636-19-3136-1-3-6, të shpallur me dt. 26.06.2020, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa për rishqyrtim (ankesa) e Operatorit Ekonomik, Segment Kosova sh.p.k, e parashtruar me datën: 08.07.2020, lidhur me tenderin: “ **Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut**”, me numër të brendshëm të prokurimit: 636-20-011-1-3-6 dhe me numër të prokurimit: 636-19-3136-1-3-6,.**
- II. Ndryshohet afati për dorëzimin e ofertave për pjesëmarrjen në aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut****
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.**

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues Komuna Junik, shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim të datës: 08.07.2020, të pranuar përmes sistemit elektronik E-Prokurimi e parashtruar nga Operatori Ekonomik, Segment Kosova sh.p.k. Duke analizuar të gjitha faktet e ofruara nga operatori ekonomik në fjalë dhe bazuar në nenin 8, paragrafi 8.1.2 ii te Rregullat për parashtrimin e ankesave, Zyra e Prokurimit të njëjtën e aprovoi si të bazuar pjesërisht.

Menjëherë, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim lënda është pezulluar nga AK.

Provë: Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit i publikuar në E- Prokurim

Sipas Kërkesës për Rishqyrtim (ankesës) nga Operatori Ekonomik, Segment Kosova sh.p.k:

Me datën 29.06.2020-Autoriteti Kontraktues "KOMUNA E JUNIKUT" Publikoi Njoftimin për Kontrate në platformën e E-prokurimit në KRPP. Në këtë rast kemi të bëjmë me "PROCEDURA E KUOTIMIT TË ÇMIMIT" për furnizime me titull "Furnizim me gjenerator për Komunën e Junikut". Me datën 13.07.2020 është afati i fundit për dorëzimin e tenderëve kurse data e fundit për Kërkesave për Sqarimin e Dosjes së Tenderit dhe Kërkesës për rishqyrtim është sot me datë 08.07.2020.

Në këtë drejtim, duke respektuar dosjen e tenderit dhe LPP sot kemi dërguar kërkesa për sqarimin e dosjes së tenderit por ende nuk kemi pranuar përgjigje dhe pasi që afati i fundit për dërgimin e kërkesës për rishqyrtim është data 08.07.2020 atëherë dorëzojmë këtë Kërkesë për rishqyrtim.

Njëjtë sikur edhe në kërkesën tonë për informacione shtesë edhe në këtë kërkesë në mënyrë respektive kërkojmë sqarim dhe ndryshim të Specifikacioneve Teknikë të kërkuar përmes Ankesit I, Specifikacioni Teknik i Detyrueshëm, kjo pasi të njëjtat janë diskriminuese dhe favorizon një prodhues të vetëm duke e caktuar specifikacionet e vetëm një kompanie të vetme. Të gjitha specifikacionet në dosje të tenderit, konkretisht në Anekin 1 janë specifikacione të një prodhuesi **CUMMINS POWER GENERATION** (gjene të bashkangjitur katalogun e prodhuesit të lartepërmendur nga i cili janë marrë specifikacionet teknike).

Konsiderojmë se kriteret e tilla të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe në Specifikimet Teknikë të përmbajtura në Aneksin I, janë në shkelje të nenit 7, 27 dhe 28 të LPP-së, të cilat e obligojnë AK të përgatisë dosjen e cila hap konkurrencën, nuk janë diskriminuese dhe sigurojnë produkte të përdorshme për AK-në. Këto specifikime teknike janë të ndërtuar në mënyrë diskriminuese, sepse kërkesa është përpiluar në favorizim të një prodhuesi specifik, gjegjësisht të prodhuesit **CUMMINS POWER GENERATION**, dhe në dëm të prodhuesve dhe operatorëve tjerë.

Në këtë drejtim, nëni 28, paragrafi 7, përcakton se: "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese".

Në këtë mënyrë kufizohet konkurrenca në vetëm ofertuesin i cili është distributor nga prodhuesi i lartepërmendur, dhe për shkak të kësaj pamundesohet ofertimi në llojet e tjera të produkteve të këtij Tenderi.

Rrjedhimisht, nga Autoriteti Kontraktues kërkojmë që kriteret në fjalë të ndryshohen dhe të lejojë ofertimi me **PRODUKTET E KUIVALENTE**.

Prandaj, mbi bazën e arsyeve të cekura më lartë, AK kërkojmë nga AK që ta aprovoj kërkesën tonë për rishqyrtim si të bazuar dhe t'i rishikoj dhe ndryshoj specifikimet teknike në mënyrë që të njëjtat të mos jenë diskriminuese dhe në mënyrë që sa më shumë operatorë ekonomik të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në tender.

Në lidhje me shkeljen e nenit 7 – Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminim dhe nenit 27- Dosja e Tenderit ju njoftoj se Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik prej fillimit të inicimit të aktivitetit të prokurimit, përpilimit të Dosjes së Tenderit dhe ofrimit të informatave shtesë ka vepruar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomik duke ju ofruar sqarime në mënyrë transparente për të gjithë operatorët ekonomik pa bërë asnjë dallim apo diskriminim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Provë: Sqarim për OE, 01.07.2020, të publikuar në E- Prokurim

Në lidhje me shkeljen e nenit 28- Specifikimet teknike, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ju njofton se, në specifikacionet teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit kemi paraqitur kërkesat bazë të cilat duhet të plotësohen dhe kjo gjë nuk

e ndalon që secili prej Operatorëve Ekonomik të interesuar të ofrojë ndonjë produkt në këtë rast gjenerator i cili i kalon kërkesat bazë (minimale) të kërkuara nga autoriteti jonë kontraktues. Në këtë rast, kriteret tona nuk janë diskriminuese sepse operatorët ekonomik janë të lirë të ofrojnë produkte ekuivalente.

Këshillë juridike:

Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroi ankesë në OSHP ,konform nenit 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik, Ligji numër 04/ L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin numër 04/L-237, Ligjin numër 05/L-068 dhe Ligjin numër 05/L-092.



U.D.Zyrtarë Përgjegjëse e Prokurimit

Me këtë Vendim të njoftohen:

- ✓ Zyra e Prokurimit
- ✓ Operatori Ekonomik, Segment Kosova sh.p.k
- ✓ Arkivi